



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 07/02/2024
PRIMLJENO
Nr. M. B. 02/59



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/
Datë: 06.02.2024

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të rregullt, e mbajtur me datë:11.12.2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/02 datë:09.01.2024, për informimin mbi aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023.
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 19.01.2024 dhe filloi në ora: 14:05. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, antarët e komisionit: Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Gentianë Hoti përfaqësuesi nga OSBE Sead Raba dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. A keni diçka për rend të ditës. Prezent jemi 4 anëtarë të Komitetit dhe nëse nuk ka diskutues e hedhi në votim rendin e ditës. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të rregullt, e mbajtur me datë:11.12.2023. A keni diçka rreth procesverbalit. Kush është për miratimin e

procesverbalit?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023. Kuvendi komunal ka marrur gjithsej 99 vendime, ka qenë një dinamik e punës sipas Planit të planifikuar për vitin 2023. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

E kam lexuar Raportin dhe pjesën më të madhe e diskutojmë në Kuvend. Kam kërkuar në vazhdimësi në mbledhjet që i kemi pasur që salla e Kuvendit për vitin 2024 duhet me qenë e funksionalizime, me ulëse me mjete teknike që të na mundësohet fjalimi nga vendi dhe ingjizimet po dalin shumë të dobëta. Nëse komuna nuk ka mjete për këtë, ne duhet me gjete një mekanizëm si e kushtëzojmë në këtë rast dhe qeverisjen komunale se si me funksionalizu punën e anëtarëve të komunës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Te vendimet dhe kërkesat e qytetarëve, a ke informatë deri ku kanë arritur me u përfundu pagesat.

Argjend Thaçi: Vetëm të muajit nëntor dhe dhjetor nuk kanë përfundu. Kush është për rekomandim për kuvend Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë po flas për këtë pjesë mirëpo le të vlen për të gjitha Komitetet dhe Komisionet. Ne si Kuvend jemi duke dalë jo të sinqerte me punën e anëtarëve të Komiteteve dhe është momenti i fundit që në si asamblistë me reflektu ndaj anëtarëve tonë së pari prej subjekteve politike por dhe kolegëve tonë që janë në këto komitete. Kanë bërë një punë aq sa kanë mundur me bërë, mirëpo pagesat nuk janë kryer ndaj asnjë Komiteti. Ne si KPF-ë kemi bërë çdo herë kërkesë dhe presion, qoftë te drejtori i financave, te kryetari dhe nënkryetari por nuk është marrur parasysht. Unë mendoj që të shkojmë në ndonjë formë tjetër. Nëse nuk ka një zotim nga drejtori i financave që kryen pagesat me datën kaq të gjitha obligimet që i ka për secilin anëtarë, atëherë ne si grup nuk e votojmë asnjë kërkesë të kryetarit që e sjellë në kuvend as për me hy në rend të ditës dhe as për me u trajtu. Nuk po ka mekanizëm tjetër që mundesh me e kushtëzu. Ne i kemi ndar 30.000.00E prej bartjes së mjeteve, enkas e kemi specifiku për këtë kategori. Ku kanë mbetur ato mjete, së pari duhet të na tregon Drejtori i Financave dhe pse s'janë kryer këto obligime.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim në Kuvend Raportin e Komitetit për Komunitete për vitin 2023?

Me vota unanime, miratohet Raporti i Komitetit për Komunitete.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023. Ky komision ka bërë një punë të jashtëzakonshme duke tejkalu planin dinamik të punës që planifikohet për 6 muaj, ky komitet ka mbajtur 12 mbledhje pavarësisht që pagesa do të kryet vetëm për 6 mbledhje. Kush është për rekomandim për Kuvend, Raportin e punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024. Si Komision

kemi mbajtur një takim të organizuar nga OSBE pikërisht rreth planit të punës së kuvendit dhe pastaj janë mbajtur dhe dy takime me anëtarët e Komisionit, ku është diskutuar për pikat që do futen në Plan të punës për vitin 2024. Kush është për rekomandim për Kuvend Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024?

Me vota unanime, rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. Kush është për rekomandim për Kuvend?

Me vota unanime, Planit të punës së Komitetit për Komunitete rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024. Kush është për rekomandim për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/02 datë:09.01.2024, për informimin mbi aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Për këtë pikë kam vërejtje, mirëpo e rekomandojmë dhe e diskutojmë në Kuvend.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.02/02 datë:09.01.2024, për informimin mbi aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Urdhëro, Sead!

Sead Raba: Një prej rekomandimeve në shumicën e komunave për shkak të grandit të performancës është që po e vendosin në muajin janar Raportin financiar. Ndoshta është më mirë të konsultoi me Salihun dhe me drejtorët tjerë.

Veton Zogaj: Raportet financiare nëse nuk diskutohet në KPF-ë mos ka probleme ligjore pastaj.

Argjend Thaçi: Raportet financiare shkojnë përmes KPF-së. Kalojmë në pikën tjetër: shqyrtimi i kërkesave. Kemi një kërkesë nga Xhezie Sertolli, për të cilën kërkoj që të bëhet plotësimi i dokumenteve. Kush është që kjo kërkesë të plotësohet me dokumente shtesë?

Me vota unanime kjo kërkesë rekomandohet që të plotësohet me dokumente shtesë.

Kërkesa tjetër është nga Veli Binishi, të cilit i kemi ndihmuar me datë:30.08.2023. Kush është që kjo kërkesë të refuzohet?

Me vota unanime, kjo kërkesë refuzohet.

Kërkesa tjetër është nga Have Hoxha, e cila kërkon ndihmë për vajzën e saj Alea Zogaj e cila është e diagnostikuar me leukemi akute dhe është duke u trajtuar me kimioterapi.

Sadik Vrenezi: Këtë kërkesë po e rekomandojmë për Kuvend.

Argjend Thaçi: Kush është që kërkesa nga Have Hoxha të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kërkesa nga Have Hoxha rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Gëzim Bytyqi, i cili kërkon ndihmë financiare për fëmijën e tij i cili është djegur dhe kërkon trajtim në Turqi. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend?

Kërkesa tjetër është nga Vlora Hoxha nga fshati Bellanicë e cila është e sëmur nga tumori në kokë. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Fitore Krasniqi, e cila kërkon ndihmë financiare për shkak të operacionit që më duhet ta kryej jashtë vendit e cili kushton 10.800.00E, mirëpo për shkak të kushteve të dobëta nuk po mund me e përfundu komplet. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 450E?

Me vota unanime, Fitore Krasniqi i ndahen 450E.

Kërkesa tjetër është nga Safet Zabelaj, i cili kërkon ndihmë financiare për trajtim të sëmundjes së djalit. Djali vuan nga diagnoza Gastroenterocolitis acuta. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 450E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 450E.

Kërkesa tjetër është nga Alis Mazreku, i cili kërkon ndihmë financiare për shpenzimet e operimit si pasoj e lëndimit të gjurit të majte gjatë kryerjes së detyrës zyrtarit në cilësinë e pjesëtares të FSK-së. Kush është që kësaj kërkesë t'i ndahn 450E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 450E.

Kërkesa tjetër është nga Ilir Toplana, i cili kërkon ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së zemrës, tensionit dhe shumë sëmundje për të cilat nuk po mundem të e gjej diagnozën, andaj shtrimi në kohë të gjatë në spital është shumë i kushtueshëm. Kush është që kësaj kërkesë ti ndahen 450E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 450E.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 14:35.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

